



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më.08.korrik.2011
Ref.Nr.:125/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 33/11

Parashtrues

Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
A.A. Nr. 66/2011, të 5 shkurtit 2011**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës-kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës e regjistruar në adresën Nëna Terezë, komuna e Fushë Kosovës, të cilën e përfaqëson z. Naser Emini nga Ferizaji i cili është sekretar i përgjithshëm i subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A.A. Nr. 66/2011 të 5 shkurtit 2011 me të cilin hidhet poshtë ankesa ndaj aktvendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia A.br. 112/2011 të 2 shkurtit 2011,

aktvendim ky me të cilin kërkesa e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDAK) për të marrë edhe një vend deputeti ishte refuzuar si e pabazuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A.A. Nr. 66/2011 duke thënë se me këtë vendim është shkelur neni 64.2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës konsideron se ky subjekt politik është dashur të marrë edhe një vend deputeti që i takon me Kushtetutë e cili i është ndarë një subjekti tjetër politik Partia e Ashkanlive për Integritim (në tekstin e mëtejme: PAI).

Baza juridike

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republika e Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: "Ligji") dhe rregulli 56 (b) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: „Rregullorja e Punës“).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën më 3 mars 2011 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: „Gjykata“).
6. Më 23 mars 2011 Gjykata Kushtetuese e njoftoi Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesin (në tekstin e mëtejme: "PZAP") si dhe Gjykatën Supreme se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetushmërisë të vendimeve të tyre..
7. Më 31 mars 2011 Gjykata Supreme e Kosovës në përgjigjen e saj theksoi se nuk kishte asgjë të re për të shtuar dhe se mendimi i tyre lidhur me këtë lëndë ishte dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 6 prill 2011 duke u përgjigjur në njoftimin tonë PZAP i përmendi arsyet e hedhjes poshtë të kërkesës së PDAK-së, dorëzoi dokumentacion plotësues dhe propozoi që kërkesa e PDAK-së të refuzohet si e pabazuar.
9. Më 9 qershor 2011 pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Prof. Dr. Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj i paraqiti gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 30 janar 2011 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) i shpalli rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme, sipas të cilave mandatet e garantuara me kushtetutën e Kosovës për komunitetet jo-shumicë Romë, Ashkali dhe Egjiptianë u takuan 4 (katër) vende të garantuara, më saktësisht:
 - Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës vota 2871 mandate 1
 - Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës vota 1690 mandate 1
 - Partia e Romëve të Bashkuar të Kosovës vota 690 mandate 1

11. Ndaj një vendimi të tillë të KQZ-së PDAK më 31 janar 2011 parashtroi ankesë në PZAP duke konsideruar se me një vendim të tillë të KQZ-së është dëmtuar PDAK duke theksuar se është shkelur Kushtetua e Republikës së Kosovës si dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, neni 111.
12. Duke vendosur lidhur me ankesën e PADK-së ndaj shpalljes të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e KQZ-së, në mbledhjen e mbajtur më 2 shkurt 2011 PZAP-i nxori aktvendimin A nr. 112/2011 dhe e hodhi poshtë ankesën e PDAK-së si të pabazuar.
13. Ndaj këtij aktvendimi të PZAP-it, më 3 shkurt 2011 PDAK parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila në seancën e mbajtur më 5 shkurt 2011 me anë të aktgjykimit A.A. nr. 66/2011 e hodhi poshtë ankesën si të pabazuar.
14. Pasi që i shteri të gjitha mjete juridike të parapara me ligj PDAK, më 3 mars 2011, e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të aktgjykimit dhe aktvendimit të lartpërmendur.

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pohon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A.A. Nr. 66/2011 të 5 shkurtit 2011 me të cilin u hodh poshtë ankesa ndaj aktvendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia A.nr. 112/2011 të 2 shkurtit 2011 me të cilin aktvendim ishte hedhur poshtë si e pabazuar kërkesa e subjektit politik PDAK për të marrë një vend deputeti më shumë është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 003/L-073.
16. PDAK pohon se ajo si parti e komuniteteve jo-shumicë është dëmtuar nga këto vendime dhe se asaj është dashur t'i takojë edhe një vend deputeti që i është dhënë subjektit politik PAI.

Ligji për Zgjedhjet në Kosovë

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 64 paragrafin 2 pika 2 i cili përcakton përbërjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës parashikon si në vijim:

*(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: **komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme;....***

18. Ligji për mbajtjen e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

19. Sipas Ligjit 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në nenin 111 me të cilin specifikohet shpërndarja e vendeve dhe mënyra e llogaritjes së numrit të vendeve të deputetëve që i kanë takuar disa subjekteve politike në Kuvendin e Kosovës parashikohet si në vijim:

“111.2 b) numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të plotë të vendeve;...”

20. Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në nenin 106. 1 parashikon si në vijim:

“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës.”

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

21. Për të qenë kërkesa e pranueshme, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese.
22. Parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 3 mars 2011, ndërsa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës më 5 shkurt 2011. Rrjedhimisht Gjykata konkludon se kërkesa është parashtruar në përputhje me nenin 49 të Ligjit.
23. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin KI 13/09 Sevdail Avdyli, të 17 qershorit 2010).
24. Në rastin e paraqitur, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë në kreun II, kreun III dhe kreun IV (nenet 21-82 të Kushtetutës) dhe se Gjykata Supreme ka marrë vendim në mënyrë arbitrare kur është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit si e pabazuar (shih *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).
25. Në lidhje me rastin konkret, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 64 paragrafi 2 pika 2 parashikon që *“një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave...” dhe jo subjektit politik që ka marrë më së shumti vota.*
26. Duke marrë parasysh se subjektet politike PDAK dhe PAI janë që të dyja përfaqësuese të komunitetit jo-shumicë Ashkali dhe se komuniteti jo-shumicë

Ashkanli i ka fituar dy vendet e parashikuara me Kushtetutë, rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (2b) të Rregullores së Punës i cili parashikon „ Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejtë kushtetuese“.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, rregullin 56 (2) dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 9 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani